

RELACION TEKNIK (PROJEKT ME PERSHKRIM)

KONTRATA NR. 1 : “MIRËMBAJTJE RUTINE DHE DIMERORE ME PERFORMANCË RRUGA K/DHUVJAN – LIBOHOVE + RRUGA VALARE – ERIND – CAJUP + RRUGA URA E LEKLIT – KELCYRE 45.3 KM”

1. Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërisë së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, apo me çdo kërkesë tjetër.

Në vecanti, ato përfshijnë detyrat menaxheriale dhe punimet fizike që lidhen me asetet dhe zërat që lidhen me rrugën:

- Asfaltimet
- Bankinat
- Sinjalistika dhe furnizimi pajisjet për sigurinë rrugore
- Strukturat e drenazhimit
- Kontrolli i vegjetacionit
- Skarpatat (gërmimet dhe bankinat)
- Veprat e artit
- Menaxhimi i trafikut
- Grumbullimi i dherave
- Pastrimi i dëborës (nqs ka mirëmbajtje dimërore)

Shërbimet që kërkon Mirëmbajtja e një rruge klasifikohen në:

2. Punimet Rehabilituese/periodike, në formën e sasisë së një vlere tavan, ndërsa tregohen sasisë e punimeve të matëshme që do kryhen në mënyrë që rruga të arrijë Standardet e asaj performancë.
3. Shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë në formën e sasisë së shprehur në një vlerë tavan mujore (kjo do jetë një sasi mujore e aplikueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së shprehur në çmim për kilometër për secilin muaj e shumëzuar me gjatësinë e rrugës dhe kohëzgjatjen e shërbimeve);
4. Punimet Emergjente në formën e një preventivi tradicional.

Funksionet kryesore të bazave të mirëmbajtjes në përgjithësi, duhet të jenë si më poshtë:

1. Mbikëqyrja e segmentit/seksionit rrugor në periudha të caktuara sipas niveleve të shërbimit
2. Kontrolli i të dhënave të trafikut për këtë segment
3. Vëzhgimi i faktorëve meteorologjikë
4. Ndihma e parë në rast aksidenti (në lidhje me elementët e rrugës dhe trafikut)
5. Mirëmbajtje në kushtet e dëshiruara të shtresave rrugore
6. Mirëmbajtja e hapësirave të parkimit, shërbimit, shenjave rrugore, sistemeve të ndriçimit, sinjalizimit të ardhshëm e telekomunikacionit.
7. Riparime dhe rindërtim pas aksidenteve rrugore
8. Riparime dhe rindërtim pas fatkeqësive natyrore
9. Operacionet e pastrimit të drenazheve, tombinove dhe objekteve të tjera që lidhen me largimin e ujrave nga sipërfaqja e rrugës

10. Të gjithë operacionet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e :
- shenjave rrugore, pajisjeve të sigurise (gardhe, parapet) sistemi i ndricimit.
 - riparimi lokal i dëmtimeve të trotuarit
 - kujdesi për bimesinë
 - aktiviteti në dimer për largimin e dëborës dhe akullit.

Punimet e mirëmbajtjes në kushtet dimërore, përfshijnë:

1. Punime paraprake para fillimit të kushteve të dimrit
2. Organizimi i vendodhjeve të depozitimit të materialeve
3. Masat mbrojtëse për borën, akullin, grumbujt e borës dhe ortekët
4. Pastrimi i dëborës nga karrexhata e autostrades dhe sinjalet e komunikacionit dhe shenjat
5. Shenjimi i anëve të karrexhatës
6. Sigurimi i funksionimit të drenazhimit nga karrexhata
7. Heqjen e automjeteve nga rruga
8. Instalimi i sinjaleve të vecanta të komunikacionit në rastet e rregjimit të trafikut të veçantë të mbylljes së rrugës.
9. Informimi i vazhdueshëm i publikut për gjëndjen e rrugës dhe rrjedhën e trafikut.

5. Segmentet që mbulon kontrata

Nr. Rrugës	Nr. Rendor	Emërtimi i Rrugëve	Kategoria e rrugës	Gjatësia totale (km)	Gjerësia (m)
SH 96	1	K/Dhuvjan – Libohove	C	8.1	5
W58	2	Valare – Erind – Cajup	F	19.3	4.5
SH 75	3	Ura e Leklit – Kelcyre	C	17.9	5
SHUMA E KONTRATES:				45.3	

6. Kusht i veçantë

Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj nqs do të përfshihen në investim (rikonstruksion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

7. Sinjalistika dhe siguria rrugore

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

8. Përshkrimi i zonës ku ndodhen rruget dhe gjendja teknike.

I – Aksi rrugor K/Dhuvjan – Libohove 8.1 km

Ky segment rrugor lidh qytetin e Libohoves me rrugen nacionale SH 4. Rruga shtrihet ne nje terren fushor dhe kodrinor me parametra planimetrike te favorshme ne segmentin km 0 – 3.5 dhe me parametra planimetrike te disfavourshme ne segmentin km 3.5 – 8.1. Parametrat altimetrike te rruges jane te favorshme ne segmentin km 0 – 6.5 dhe shume te veshtira ne segmentin km 6.5 – 8.1. Eshte nje aks i rendesishem nga pikpamja social – ekonomike pasi i sherben nje komuniteti te madh banoresh dhe shume bizneseve te karakterit bujqesor, blegtoral dhe agroturistik. Eshte nje rruge qe te con ne destinacione turistike sic eshte Kalaja e Libohoves etj.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.


Shtresat asfaltike janë në gjendje pjeserisht të mirë por ka nevoja për riparime dhe riveshje me asfaltobeton.

Kanalet anësore, tombinot dhe veprat e artit kanë nevojë për pastrim të pjesshëm dhe mirembajtje sistematike. Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për permiresime, rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme. Kjo rruge ka 4 ura te medha qe ndodhen ne tre km e para te saj. Ato paraqiten te amortizuara dhe kane nevojje per riparime dhe mirembajtje, sidomos dy urat e para, Ura e Dhuvjanit dhe Ura e Xhait. Rruga është në terren fushor dhe kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore. Nga pikpamja e Mirembajtjes Dimerores rruga nuk paraqet probleme te medha. Reshjet e deboret jane te rralla. Formimi i ngricave dhe akullit ne stinen e dimrit eshte evident ne rastet e temperaturave te uleta dhe duhet te menaxhohet.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.

Koordinat gjeografike te fillimit: 39°59'50.7", 20°12'57.5"

Koordinat gjeografike te mbarimit : 40°02'00.6", 20°15'44.3"



II – Aksi rrugor Valare – Erind – Cajup 19.3 km

Ky segment rrugor lidh qytetin e Gjirokastrës krahinen e Lunxherise dhe me malin e Cajupit. Eshte nje rruge e rendesishme nga pikpamja social – ekonomike pasi kalon ne disa qendra te banuara, i sherben nje komuniteti te madh banoresh dhe shume bizneseve te karakterit bujqesor, blegtoral dhe agroturistik. Eshte nje rruge qe te con ne destinacione turistike konkretisht ne fushen e Cajupit, per turizem malor.

Rruga shtrihet ne nje terren kodrinor – malor me parametra planimetrike te disfavorshme ne te gjithe gjatesine e tij. Edhe parametrat altimetrike te rruges jane te disfavorshme ne te gjithe gjatesine e tij. Pjesa me e madhe e aksit shtrihet ne nje terren malor shume te thyer. Rruga eshte rikonstruktuar nga Fondi Shqiptar i Zhillimit para 15 vitesh ne te gjithe gjatesine e saj.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në gjendje pjeserisht të mirë por ka nevojë për riparime.

Kanalet anësore, tombinot dhe veprat e artit kanë nevojë për pastrim të pjesshëm dhe mirembajtje sistematike. Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Kjo rruge ka 1 ure te madhe qe ka nevoje per riparime te vogla dhe mirembajtje.

Ne km-7.5 te aksit prej vitesh eshte aktivizuar nje reshqitje masive te trupit te rruges qe nuk mund te rehabilitohet nga kontrata prandaj duhet te mbahet ne monitorim te vazhdueshem dhe te kryhen punime provizore per qarkullim normal.


Ky aks rrugor paraqet problematika gjatë periudhës të dimrit dhe nevojitet mirëmbajtje dimërore pasi lartesia arrin deri në 1200 m mbi nivelin e detit. Problem perben edhe renia e gureve e inerteve nga shpatet e rruges km 5 – 19.3, prandaj kerohet vemendje e vecante per trajtimin eketyre problematikeve.

Rruga është në terren kodrinor – malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.

Koordinat gjeografike te fillimit: 40°07'35.0", 20°08'09.6"

Koordinat gjeografike te mbarimit : 40°11'05.9", 20°10'58.1"



III – Aksi rrugor Ura e Leklit - Këlcyrë 17.9 km

Ky segment rrugor lidh qytetin e Kelcyres me rrugen nacionale SH 4. Eshte pjese e rruges Gjirokaster – Korce. Rruga shtrihet ne nje terren fushor dhe kodrinor me parametra planimetrike pergjithesisht te disfavorshme pasi ne shume pika rruga zhvillohet me kthesa te forta. Gjithashtu gjeresia e rruges eshte e vogel. Parametrat altimetrike te rruges jane te favorshme pothuajse ne te gjithe gjatesine e saj.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në gjendje pjeserisht të mirë por ka nevoja për riparime dhe riveshje me asfaltobeton. Ne 5 km e para te aksit jane aktivizuar deformime te trupit te rruges qe duhet te mbahen nen monitorim.

Kanalet anësore, tombinot dhe veprat e artit kanë nevojë për pastrim të pjesshëm dhe mirembajtje sistematike. Veprat e artit paraqiten te amortizuara prandaj kane nevoje per riparime periodike.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Ky aks rrugor ka 2 ura te medha metalike dhe nje ure te madhe perj b/a. Ato paraqiten te amortizuara dhe kane nevoje per riparime dhe mirembajtje.

Ne km – 0.1 dhe km – 6 te aksit rrugor Ura e Leklit – Kelcyre ndodhen urat metalike te Leklit dhe Dragotit. Keto jane ura metalike me kapriata me brez te siperm drejtkendor dhe poligonal me gjatesi perkatesisht 80 m dhe 115 m. Keto dy ura jane ndertuar para rreth 90 vitesh dhe paraqiten ne nje gjendje te amortizuar megjithe nderhyrjet qe jane bere me riparime. Nje problem shqetesues vazhdimisht ka qene kalimi i mjeteve me ngarkese, me tonazh te larte ne keto ura. Kalimi mbi keto ura i automjeteve me tonazh te larte mund te rrezikoj qendrueshmerine e urave. Pervec sinjalistikes tjeter rrugore ne keto ura ekziston edhe sinjalistika ku percaktohet kufizimi i tonazhit.

Ky aks rrugor paraqet problematika gjate periudhes te dimrit dhe kryesisht me rreshqitjen e dherave dhe me prezencen e ngricave ne zonen e Dragotit, km 1-6 dhe ne zonen e Grykes se Kelcyres km 12-17.

Rruga eshte ne terren fushor dhe kodrinor me nje karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kerkuar i sherbimit “i mire”.

Koordinat gjeografike te fillimit: 40°15'28.1", 20°03'19.5"

Koordinat gjeografike te mbarimit : 40°18'48.4", 20°11'32.3"



GRUPI I PUNES